



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 89, DATË 08.10.2020

PËR

**KALIMIN E TË DREJTAVE QË BUROJNË NGA LICENCA E SUBJEKTIT
PERSON FIZIK ORJANA CENKO, PËR TRANSMETIME AUDIOVIZIVE “TV
CHANNEL 7” TEK SHOQËRIA “CHANNEL 7” SH.P.K.**

Autoriteti i Mediave Audiovizive, i përbërë nga:

Gentian	Sala	Kryetar
Sami	Nezaj	Zëvendëskryetar
Agron	Gjekmarkaj	Anëtar
Gledis	Gjipali	Anëtar
Suela	Musta	Anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen që i përket palëve:

Kërkues: Subjekti person fizik Orjana Cenko

Objekt: Kalimi i të drejtave që burojnë nga licenca e subjektit person fizik Orjana Cenko, për transmetime audiovizive “Tv Channel 7” tek shoqëria “Channel 7” sh.p.k.

Baza Ligjore: Neni 19, pika 16, neni 55, pika 6 dhe neni 62, pika 6 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

VËREN SE:

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (KKRT), sot Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), me vendimin nr. 241, datë 21.05.2004, licencoi subjektin person fizik Orjana Cenko, për operatorin televiziv privat vendor “Tv Channel 7”, për të mbuluar me sinjal qytetin Gjirokastër. AMA, me vendimin nr. 134, datë 22.10.2010, ka rinovuar licencën e këtij subjekti. AMA, me vendimin nr. 123, datë 08.06.2016, rinovoi dhe zëvendësoi licencën e subjektit me licencë për transmetime audiovizive. Afati i vlefshmërisë së licencës së subjektit përfundon në datën e mbylljes së transmetimeve analoge në qarkun Gjirokastër.

Subjekti person fizik Orjana Cenko, ka qenë i licencuar dhe për subjektin audio privat vendor “Radio Channel 7”, për të cilin AMA, me vendimin nr. 71, datë 25.04.2019, vendosi heqjen e licencës për shkak të mos shlyerjes së detyrimeve financiare.

Subjekti person fizik Orjana Cenko, me shkresën nr. 37 prot., datë 09.08.2020, administruar në AMA me nr. 2188 prot., datë 11.08.2020, ka depozituar kërkesën lidhur me kalimin e të drejtave që rrjedhin nga licenca për subjektin audioviziv “Tv Channel 7”, te shoqëria “Channel 7” sh.p.k.

Bashkëlidhur njoftimit, subjekti ka depozituar:

1. Kërkesë për ndryshimin e statusit të subjektit nga person fizik në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.
2. Certifikatën e regjistrimit si shoqëri, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB).
3. Ekstraktin Historik të Regjistrimit Tregtar të QKB-së, lëshuar në datën 06.08.2020, nga i cili rezultoi se:
 - Shoqëria "Channel 7" është regjistruar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në datën 06.08.2020;
 - NIPT i subjektit është: M03206602O;
 - Objekti i aktivitetit është "Veprimtari Radio Televizive";
 - Ortak i shoqërisë është Orjana Çenko me 100% të kuotave, njëkohësisht dhe administrator i shoqërisë;
 - Selia e subjektit është: Lagjja "18 Shtatori", Rruga nacionale "Gjirokastër-Kakavie", godinë 3-katëshe, kati 2-të, nr. pasurie 7/5, ZK 8541, Gjirokastër;
 - Nr. tel: 0695157557; Email: channel7televizion@yahoo.com;
 - Emri tregtar: "CHANNEL 7";
 - Statusi: Aktiv.

Në nenin 62 të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar parashikohet se: "6. Licenca lokale apo rajonale e transmetimit audio dhe licenca lokale apo rajonale e shërbimit të transmetimit audioviziv u jepet personave juridikë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, me objekt ekskluziv veprimtarinë audiovizive". Në nenin 55, pika 6, të po këtij ligji përcaktohet se: "... Në rast se mbajtësi i licencës dhe/ose autorizimit, hyn në marrëdhënie juridike civile, objekt i të cilave është edhe veprimtaria e licencuar/autorizuar, atëherë për cedimin ose kalimin e të drejtave që burojnë nga licenca dhe/ose autorizimi kërkohet miratimi i AMA-s. Subjektit që ka fituar këto të drejta, miratimi i jepet në formën e një licence dhe/ose autorizimi të ri me të njëjtën përmbajtje. ...".

Sa më sipër, kërkesa e subjektit është e mbështetur në ligj e në prova,

PËR KËTO ARSYE,

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në mbështetje të nenit 19, pika 16, nenit 55, pika 6 dhe nenit 62, pika 6 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

V E N D O S I

1. Pranimit e kërkesës së subjektit person fizik Orjana Cenko, licencuar për transmetime audiovizive analoge "Tv Channel 7", duke kaluar të drejtat dhe detyrimet e licencës tek shoqëria "Channel 7" sh.p.k., me NIPT: M03206602O, administrator Orjana Çenko, me afat vlefshmërie deri në mbylljen e transmetimeve analoge në qarkun Gjirokastër.
2. T'i heqë subjektit person fizik Orjana Cenko, me NIPT: K52926608A, licencën për transmetime audiovizive analoge "Tv Channel 7".
3. Ngarkohet administrata e AMA-s për veprime të mëtejshme sipas ligjit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:

Gentian

SALA

Zëvendëskryetar:

Sami

NEZAJ

Anëtarë:

Agron

GJEKMARKAJ

Gledis

GJIPALI

Suela

MUSTA